

**VENDIM**  
**Nr.977, datë 8.10.2009**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.856, DATË 5.8.2009 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË  
CIKLIT TË PARË “GJUHË-LETËRSI SHQIPE DHE FRËNGE”, NË UNIVERSITETIN  
“FAN.S.NOLI” TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.856, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“1.Hapjen në universitetin “Fan. S. Noli” të Korçës, në fakultetin e mësuesisë, të programit të studimit “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP), në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”.”.
  2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:  
“3/1. Kuota e pranimit në programin e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge” është 50 (pesëdhjetë).
  3. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:  
“4/1. Tarifa e shkollimit në programin e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge” është 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**